

## REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE 2023

Nr. Rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
1.	10.01.2023	Kërkesë për t'u pajisur me informacion rreth numrit total të aplikimeve për përfitimin e bursave sipas VKM nr.666 dt. 10.10.2019, numrin e përfituesve të nxënësve të arsimit të mesëm profesional si edhe numrin e përfituesve të nxënësve të arsimit bazë.	11.01.2023	Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion datë 10.01.2023, ju bëjmë me dije se: 1. Numri total i aplikimeve të nxënësve për përfitimin e bursave sipas VKM nr. 666, dt.10.10.2019 është 985 nxënës. 2. Numri i nxënësve përfitues të arsimit të mesëm profesional është 503 nxënës. Numri i nxënësve përfitues të arsimit të mesëm të përgjithshëm është 87 nxënës. 3. Numri i nxënësve përfitues të arsimit bazë është 263 nxënës.	E plotë	S'ka tarifë
2.	12.01.2023	Kërkesë për t'u pajisur me informacion mbi numrin e nxënësve të arsimit bazë që kanë aplikuar për t'u trajtuar me bursë, sa nga këta nxënës që kanë aplikuar i përkasin kategorisë “familje në nevojë”, si edhe sa prej tyre janë përfitues.	23.01.2023	Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion datë 12.01.2023, ju bëjmë me dije se: 1. Numri i nxënësve të arsimit bazë që kanë aplikuar për t'u trajtuar me bursë është 395 nxënës dhe 87 nxënës të arsimit parauniversitar (gjimnaze). 2.a) Numri i nxënësve të arsimit bazë që përfituan bursë sipas kriterit ekonomik (në pamundësi ekonomike) dhe jo-ekonomik,(kriteret të përcaktuar nga	E plotë	S'ka tarifë

				<p>Ministria e Arsimit mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.666 datë 10.10.2019 dhe vendimit nr.511 datë 27.07.2022) është 263 nxënës.</p> <p>b)Numri i nxënësve të arsimit parauniversitar (gjimnaze të përgjithshme) që përfituan bursë sipas kriterit ekonomik dhe jo-ekonomik (kriteret të përcaktuar nga Ministria e Arsimit mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.666 datë 10.10.2019 dhe vendimit nr.511 datë 27.07.2022) është 87 nxënës.</p> <p>3.Numri i nxënësve të arsimit bazë që i përkasin kategorisë "familje në nevojë" që s'kanë përfituar bursë është 132 nxënës dhe numri i nxënësve të arsimit parauniversitar (gjimnaze) që s'kanë përfituar bursë është 1 nxënës.</p> <p>- Theksojmë që për numrin e bursave për të përfituar bursë, nxënësit që ndjekin arsimin bazë dhe parauniversitar me kohë të plotë në institucionet arsimore publike, plani nga Ministria e Arsimit dhe Sportit ka qenë 300 bursa sipas shkresës nr.6478/54 Prot datë 11.11.2022 dhe 50 Bursa shtesë sipas shkresës nr.6478/64 Prot datë 21.12.2022.</p>		
--	--	--	--	--	--	--

				<p><b>- Theksojmë se nxënësit që s'kanë përfituar bursë</b> (familje në nevojë) sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.666 datë 10.10.2019 dhe vendimit nr.511 datë 27.07.2022) dhe pas miratimit të buxhetit ekonomik financiar të Bashkisë Korçë do t'ju miratojë dhe shpërndajë bursa nga fondet e veta ose nga fondet buxhetore të përfituara në formën e transfertës së pakushtëzuar.</p> <p>Bashkangjitur po ju vendosim në dispozicion Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.180 datë 28.12.2022.</p>		
3.	19.01.2023	Kërkesë për t'u pajisur me informacion mbi rikonstruksionin e shkollës "Themistokli Gërmenji", kur kanë nisur punimet dhe kur pritet të përfundojnë, kur do të nisin mësim nxënësit në shkollën e rikonstruktuar si edhe sa është kapaciteti i kësaj shkolle.	24.01.2023	<p>Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion datë 19.01.2023, ju bëjmë me dije se:</p> <p>Punimet për rikonstruksionin e shkollës "Themistokli Gërmenji" filluan në vitin 2022 pas çeljes së fondeve nga Ministria e Arsmimit dhe Sportit. Punimet kanë filluar në mbështetje të Kontratës Nr. 8405/2 prot. në datë 13.10.2022 dhe do të përfundojnë në datë 13.04.2023. Mësimi do të fillojë pasi të përfundojnë punimet. Kapaciteti i kësaj shkolle është rreth 600 nxënës.</p>	E plotë	S'ka tarifë

4.	18.01.2023	Kërkesë për t'u pajisur me informacion mbi mbështetjen financiare të dhënë për OJF-të gjatë 2022, formën e kësaj mbështetje, sa OJF kanë aplikuar dhe sa kanë përfituar etj	30.01.2023	<p>Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion datë 18.01.2023, po ju vendosim në dispozicion informacionin e kërkuar:</p> <p><b>1. A keni ofruar mbështetje financiare per organizatat jofitimprurese (OJF) gjate vitit 2022?</b></p> <p>Në buxhetin e vitit 2022, me qëllim mbështetjen e OJF-ve u miratua fondi në vlerën 2,000,000 lekë për realizimin e një Thirrje Publike për OJF-të, bazuar në Metodologjinë LOD.</p> <p><b>2. Nëse keni ofruar mbështetje financiare, cila ka qenë forma e mbështetjes (grant, kontrata shërbimi, prokurim publik/tenderim, etj.)</b></p> <p>Mbështetja financiare është bërë përmes nënshkrimit të kontratës me OJF fituese për zbatimin e projektit, prioritetet e të cilit përputhen me prioritetet strategjike të Bashkisë.</p> <p><b>3. Sa OJF kane aplikuar per mbeshtetje financiare gjate vitit 2022? Ju lutem, specifikoni sipas formen e mbeshtetjes, nese ka patur me shume se nje forme.</b></p> <p>Në lidhje me thirrjen publike të publikuar nga Bashkia Korçë për vitin 2022, aplikuan 2 OJF dhe një</p>	E plotë	S'ka tarifë
----	------------	---	------------	--	---------	-------------

			<p>prej tyre u shpall fituese nga Komisioni i vlerësimit të projekt propozimeve. Projektet që kanë fituar numrin më të madh të pikëve dhe kanë zbatuar udhëzimet e kërkuara sipas “Metodologjisë LOD” kanë pasur prioritet për t’u përzgjedhur fituese.</p> <p><b>4. Sa OJF kane perfituar nga kjo mbeshtetje? Ju lutem, specifikoni sipas formes se mbeshtetjes nese ka patur me shumë së nje forme.</b>          Forma e mbështetjes financiare për OJF-të është bazuar në Metodologjinë LOD ( dokumenti është përgatitur në kuadër të zbatimit të Projektit “ReLOaD”, zbatuar nga Programi për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP).</p> <p><b>5. Cila ka qene buxheti i disbursuar per organizate dhe ne total? Ju lutem, specifikoni sipas formes nese ka patur me shume se nje forme?</b>          Forma e dhënies se mbështetjes financiare për OSHC-të bazohet në “Metodologjine LOD”, dokument i cili është përgatitur në kuadër të zbatimit të Projektit “ReLOaD”, i cili ka për qëllim përforcimin e demokracisë vendore të zbatuar në Bosnjë dhe Hercegovinë, zbatuar</p>	
--	--	--	--	--

			<p>nga Programi për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP).</p> <p><b>6. Keni ofruar mbeshtetje jofinanciare gjate vitit 2022? Cila eshte baza ligjore rregullatore qe rregullon kete forme mbeshtetjeje?</b></p> <p>Përfituese të mbështetjes jofinanciare në qytetin e Korçës kanë qenë të gjitha organizatat lokale si edhe organizata të tjera, të cilat kanë qëllim realizimin e aktiviteteve të tyre në territorin e Bashkisë Korçë. Përmendim angazhimin dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm me organizatat lokale, të cilat kanë qenë dashamirëse dhe tepër bashkëpunues në nisma dhe aktivitete të realizuara përmes bashkëpunimit të ngushtë me Bashkinë.</p> <p>Baza ligjore: Ligji Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, Neni 64 "Kompetencat dhe detyrat e kryetarit të bashkisë".</p> <p><b>7. Nese keni ofruar mbeshtetje financiare, sa OIF kane perfituar nga kjo mbeshtetje? Cili ka qene Iloji i mbeshtetjes jofinanciare te ofruar (mjedise, trajnime, ndarje eksperiencash, etj)</b></p>	
--	--	--	--	--

			<p>Bashkia Korçë ka ofruar mbështetje për realizim aktiviteteve të përbashkëta duke ofruar lehtësi në ofrim mjediesh falas, ndarje eksperiencash etj, duke mirëpritur gjithmonë bashkëpunimin e vazhdueshëm me OJF-të lokale dhe më gjerë.</p> <p><b>8. Sa është numri i konsultimeve publike të realizuara nga institucioni juaj gjatë vitit 2022?</b> Për thirrjen publike të realizuar nga Bashkia Korçë për vitin 2022, u realizua një konsultim publik me pjesëmarrjen e OJF-ve të interesuara për të aplikuar në Thirrjen Publike të publikuar nga Bashkia Korçë.</p> <p><b>9. A ka institucioni juaj koordinator për njoftimin dhe konsultimin publik? Nëse po, ju lutem citoni kontaktin.</b> Po. Larisa Katundi E-mail: larisakatundi5@gmail.com</p> <p><b>10. A ka institucioni juaj koordinator për shoqëri civile?</b> Nëse po, ju lutem citoni kontaktin. Bashkia Korçë nuk ka të emëruar një koordinator për shoqëri civile, por për zbatimin e projekteve të ndryshme, punonjësit e Drejtorisë së Kujdesit Social</p>	
--	--	--	--	--

			<p>pranë bashkisë bashkëpunojnë ngushtë me OJF-të për zbatimin e projekteve, kryesisht projekte sociale, të cilat kanë në vëmendje mbështetjen për familjet, fëmijët, shtresat në nevojë etj.</p> <p><b>11. Sa OJF kane marre pjese ne konsultime publike te organizuara nga Institucioni juaj?</b></p> <p>Njoftimi për konsultimet publike të organizuara nga Bashkia Korçë për të gjithë të interesuarit që duan të marrin pjesë bëhet përmes njoftimeve zyrtare nga institucioni si edhe përmes rrjeteve sociale dhe faqes zyrtare të ëeb-it. Vitet e fundit vihet re një pjesëmarrje e ulët e OJF-ve në takimet konsultuese të realizuara nga institucioni.</p> <p><b>12. Sa perqind (%) e projektligjeve i larisaakteve nenligjore te hartuara nga institucioni juaj jane si rezultat I konsultimeve me OJF-te?</b></p> <p>Janë zhvilluar konsultime publike me OJF-të, përfaqësues të shoqërisë civile apo grupe të ndryshme interesi për ato akte që sipas ligjit kërkojnë konsultim publik.</p>	
--	--	--	---	--

			<p><b>13. A jane te perfshire perfaqesues te OJF-ve ne organe keshillimore te institucionit tuaj? Nese PO, cilat jane keto organe keshillimore dhe sa OJF jane te perfshire ne to?</b></p> <p>Këshilli Rinor ka në përbërje të tij përfaqësues të rinj nga OJF-të.</p> <p><b>14. A jane perfshire OJF ne grupet e punes se ngritura te institucionit tuaj? Nese PO, cilat jane keto grupe pune dhe sa OJF jane te perfshire ne to?</b></p> <p>Për projekte që Bashkia zbaton në fusha të ndryshme, realizohen takime me anëtarët e grupit të punës si edhe ftohen të marrin pjesë përfaqësues të OJF-ve sipas natyrës (fushës së veprimtarisë) së aktiviteteve që zhvillohen.</p> <p><b>15. A eshte trajnuar stafi juaj mbi veprimtarine dhe funksionimin e OJF-ve? Nese po, sa punonjes jane trajnuar?</b></p> <p>Nga stafi i bashkisë jane trajnuar 2 punonjës, të cilët kanë ndjekur përgatitjen e paketës së aplikimit për thirrjen publike, dokumentacionin në vazhdim për aplikantët e interesuar, mbledhjen e aplikimeve, mbarëvajtjen e procesit të vlerësimit të aplikimeve deri në shpalljen e OJF-ve fituese dhe më</p>	
--	--	--	--	--

				<p>pas ndjekjen dhe monitorimin e zbatimit të projekt propozimit fitues.</p> <p><b>16. A ka lincensuar institucioni Juaj OJF qe ofrojne sherbime te caktuara? Nese po, sa OJF jane lincensuar? Per cfare sherbimesh jane lincensuar?</b></p> <p>Në qytetin e Korçës ushtrojnë aktivitetin e tyre rreth 30 organizata të shoqërisë civile, të cilat në fokus të veprimtarisë së tyre kanë mbështetjen e vajzave dhe grave, komunitetit në nevojë, fëmijët, mjedisin, turizmin, sipërmarrjen dhe zbatojnë projekte në fusha të ndryshme.</p>		
5.	23.01.2023	Kërkesë për t'u pajisur me informacion në çfarë faze janë punimet për ndërtimin e aeroportit turistiko-sportiv në Korçë, kur parashikohet të përfundojë projekti, sa është vlera e tij, kush po e zbaton, si edhe për çfarë është planifikuar të shërbejë ky projekt.	24.01.2023	<p>Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion datë 23.01.2023, ju bëjmë me dije se:</p> <p><b>1. Në çfarë faze janë punimet për ndërtimin e aeroportit turistiko-sportiv në Korçë?</b></p> <p>Faza e parë e punimeve ka përfunduar dhe aerodromi është gati për fluturimet e para sportivo-turistike. Në këtë fazë përfshiheshin rievimi i pistës, rrethimi, sinjalistika.</p> <p><b>2. Kur parashikohet të përfundojë projekti?</b></p> <p>Projekti është konceptuar në disa faza. Theksojmë se aerodromi është</p>	E plotë	S'ka tarifë

				<p>për fluturime të vogla turistiko-sportive si dhe për emergjencat civile.</p> <p><b>3. Sa është vlera e projektit?</b> Vlera e angazhuar nga Bashkia Korçë është 7 209 600 lek.</p> <p><b>4. Kush po e zbaton këtë projekt?</b> Bashkia Korçë në bashkëpunim me Ministrinë e Mbrojtjes (sipas një marrëveshje bashkëpunimi, Ministria e Mbrojtjes angazhoi mjetet për rilevimin e fushës). Pjesa tjetër e punimeve realizohet nga punonjësit e Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike pranë Bashkisë Korçë.</p> <p><b>5. Për çfarë është planifikuar të shërbejë ky projekt?</b> Për zhvillimin e turizmit të aventurës. Aeroporti do të akomodojë fluturime të avionëve të vegjël turistiko-sportive. Ndërkohë do të shërbejë edhe për ujlën e avionëve në rastet e emergjencave civile.</p>		
6.	16.02.2023	Kërkesë për t'u pajisur me informacion në lidhje me qendrat komunitare që janë hapur që prej vitit 2015 në varësi të Bashkisë Korçë dhe a janë funksionale, të dhëna	27.02.2023	<p>Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion datë 16.02.2023, ju bëjmë me dije se:</p> <p>1. Që prej vitit 2013 Bashkia Korçë ka hapur katër qendra komunitare për fëmijët në nevojë. Në këto qendra 80% e fëmijëve i përkasin komunitetit rom dhe egjiptian.</p>	E plotë	S'ka tarifë

		<p>mbi numrin e pjesëtarëve të minoritetit rom që janë trajtuar me politikat e strehimit nga viti 2015 deri në vitin 2022.</p>	<p>Shërbimet që ofrohen tek këto qendra janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Përgatitja e detyrave të shtëpisë pas përfundimit të mësimit;</li> <li>-Ngrënia e një vakti ushqimor (dreka);</li> <li>-Aktivitete psiko-sociale;</li> <li>-Mbështetje me kite shkollore;</li> <li>-Pjesëmarrja në kampet verore të organizuara nga bashkia;</li> <li>-Mbështetje edhe për familjet e tyre.</li> </ul> <p>Gjithashtu, Bashkia Korçë ka ngritur edhe katër qendra ditore për moshën e tretë ku 50% e të moshuarve janë nga komunitetet rome dhe egjiptiane. Shërbimet që ofrohen:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Kafe,çaj;</li> <li>-Gazeta si dhe aktivitete psiko-sociale;</li> <li>-Mbështetje për të moshuarit e vetmuar me pako ushqimore.</li> </ul> <p>2. Të dhënat nga viti 2015 deri në vitin 2022 për numrin e familjeve të minoritetit rom dhe egjiptian që janë trajtuar me programet e strehimit social në Bashkinë Korçë janë:</p> <p>1-Përmirësim i kushteve të banesave ekzistuese: mbi 80 familje.</p>		
--	--	--	---	--	--

				<p>2-Banesa sociale me qira : 25 familje.</p> <p>3-Subvencionimin e qirasë: 10 familje.</p> <p>4-Banesa me kosto të ulët: 6 familje.</p> <p>4-Subvencioni i interesave të kredisë: 3 familje.</p> <p>Nga viti në vit ka përpjekje për punësim, kusht i domosdoshëm për të siguruar strehim të përshtatshëm, të përballueshëm dhe për të përfituar nga programet e strehimit social në funksion të rritjes së cilësisë së jetesës.</p>		
7.	20.02.2023	Kërkesë për informacion nëse ka qendra rinore pranë Bashkisë Korçë dhe nëse ka të saktësohet numri i qendrave, emërtimi i tyre si dhe objekti i veprimtarisë.	27.02.2023	<p>Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion datë 20.02.2023, ju bëjmë me dije se: Bashkia Korçë ka krijuar një qendër e cila quhet "Korca Innovation Technology Hub", ku të rinjtë marrin informacion dhe trajnohen në fusha të ndryshme të teknologjisë së informacionit dhe programimit nëpërmjet bashkëpunimit me Universitetin e Biznesit dhe Teknologjisë Prishtinë.</p> <p>Gjithashtu është ngritur edhe Qendra Sportive Korçë, një qendër multifunksionale sportive ku të rinjtë shpenzojnë kohën e tyre në</p>	E plotë	S'ka tarifë

				disiplina të ndryshme sportive dhe argëtim.		
8.	21.02.2023	Kërkesë për informacion në lidhje me fshatin Lavdar, çfarë projekte dhe investime ka në plan Bashkia Korçë të bëjë për këtë fshat.	27.02.2023	<p>Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion datë 21.02.2023, ju bëjmë me dije se:</p> <p><b>1. A ka ndonjë projekt Bashkia Korçë në lidhje me fshatin Lavdar që të kthehet në fshat turistik?</b> - Jo.</p> <p><b>2. Nëse po, çfarë vlerë do të ketë ky projekt?</b></p> <p><b>3. Nëse po, në çfarë faze është projekti?</b></p> <p><b>4. Nëse jo, a është planifikuar që të ketë një projekt të tillë për fshatin Lavdar?</b> Për momentin nuk kemi planifikime për një projekt të tillë.</p> <p><b>5. Çfarë projekte/investime të tjera ka bërë ose do të bëjë Bashkia Korçë për fshatin Lavdar?</b> -Mur mbajtës për arsye të rrëshkitjes së dheut (Lavdar i Vjetër) -Çakullim dhe sistemim i rrugës Voskop-Lavdar i Vjetër -Riparim i rrugës</p>	E plotë	S'ka tarifë

				-Riparim kalldrëmi në sheshin e fshatit.		
9.	06.03.2023	Kërkesë për t'u pajisur me informacion nëse ka ose jo ujë të pijshëm, sa depo uji ka dhe a janë funksionale si edhe investimet që ka bërë Bashkia Korçë në lidhje me ujësjellësin dhe kanalizimet në fshatin Lavdar.	15.03.2023	Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion datë 06.03.2023, ju bëjmë me dije se: <b>1. A ka ujë të pijshëm në fshatin Lavdar të Korçës?</b> - Jo. <b>2. Sa orë në ditë banorët kanë ujë të pijshëm?</b> <b>3. Sa depo uji ka në fshatin Lavdar?</b> - Tre depo uji. <b>4. A janë depot e ujit funksionale?</b> - Një depo uji është funksionale. <b>5. Çfarë investimesh ka bërë Bashkia Korçë në lidhje me ujësjellësin dhe kanalizimet në fshatin Lavdar?</b> - Uji i fshatit Lavdar nuk administrohet nga Shoqëria Rajonale e Ujësjellës-Kanalizime Korçë.	E plotë	S'ka tarifë

10.	07.03.2023	Kërkesë për t'u pajisur me informacion mbi procedurën e ndjekur nga Bashkia Korçë në lidhje me hartimin e planit të mbarështrimit për Ekonominë Pyjore Sherrë-Panarit, informacion mbi procedurën e ndjekur për VKB Nr.150 datë 31/10/2019, hartën e paraqitur dhe miratuar me VKB Nr.150 datë 31/10/2019 etj	20.03.2023	Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion datë 07.03.2023, ju bëjmë me dije se: Për procedurat që kemi ndjekur i jemi referuar legjislacionit në fuqi. Procedura e ndjekur është vlerësuar nga Këshilli Bashkiak me vendimet përkatëse. Në tabelën krahasuese që keni bërë, ju keni përfshirë dhe ekonominë Kullosore Sherrë – Panarit, e cila është ekonomi kullosore. Për këtë arsye ju del diferenca 1971.2 ha. Në Planin e Mbarështrimit të Ekonomisë Pyjore Sherrë-Panarit është përfshirë dhe një pjesë e Ekonomisë Kullosore Sherrë-Panarit. Në VKM-në Nr. 398 janë vetëm pyjet dhe kullotat të cilat i janë transferuar në pronësi Bashkisë Korçë, pyjet dhe kullotat private nuk përfshihen në këtë VKM.	E plotë	S'ka tarifë
11.	05.04.2023	Kërkesë për t'u pajisur me informacion mbi: A janë në pronësi të Bashkisë Korçë ambientet e “Qytezës së Fëmijësve”, kush ushtron të drejtën e përdorimit dhe posedimit të kësaj qendre, duke përfshirë	12.04.2023	Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion datë 05.04.2023 sipas informacioneve të marra nga Drejtoria e Përgjithshme Juridike, ju bëjmë me dije se: Qyteza e Fëmijëve është në administrim të Qendrës Sportive Korçë, shoqëri aksionare me kapital 100% në pronësi të Këshillit Bashkiak Korçë.	E plotë	S'ka tarifë

		dhe menaxhin e saj, informacion edhe mbi ambientet e Qendrës Sportive Korçë nëse janë në pronësi të Bashkisë Korçë dhe nga cili subjekt bëhet administrimi i tyre.		Qyteza e Fëmijëve administrohet nga Qendra Sportive Korçë Sh.a, e cila ushtron të drejtën e përdorimit dhe menaxhimin e saj, sipas tarifave të miratuara me Vendim të Këshillit të Bashkisë Korçë.		
12.	07.04.2023	Kërkesë për t'i vendosur në dispozicion raportin e plotë të fizibilitetit të realizuar për aeroportin e Lumalasit nga kompania private IDRA për Bashkinë Korçë.	11.04.2023	Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion datë 07.04.2023, ju bëjmë me dije se: Bashkia Korçë nuk ka porositur studim fizibiliteti për aeroportin e Lumalasit.	E plotë	S'ka tarifë
13.	13.04.2023	Kërkesë për t'u pajisur me informacion në lidhje me ofrimin e shërbimeve të arsimit në fëmijërinë e hershme në Bashkinë Korçë.	24.04.2023	Kërkuesit i është vendosur në dispozicion informacioni i kërkuar sipas listës së paraqitur në email. (informacioni është dërguar në formë table)	E plotë	S'ka tarifë
14.	24.04.2023	Kërkesë për të vendosur në dispozicion kopjet e planeve të reja të menaxhimit të financuara nga Projekti i Shërbimeve Mjedisore një bashkëfinancim i	28.04.2023	Pranë Koordinatorit për të Drejtën e Informimit në datë 24.04.2023 është deleguar kërkesa për informacion nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit. Nga informacioni i marrë nga Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave, Bashkia Korçë ju bëjmë me dije se:	E plotë	S'ka tarifë

		Bankës Botërore, SIDA dhe GEF.		Nuk mund të pajiseni me kopje të këtyre planeve pasi janë në proces për t'u miratuar.		
15.	18.04.2023	Kërkesë për t'u pajisur me informacion në lidhje me numrin e familjeve të komunitetit rom dhe egjiptian që jetojnë në bashkinë e Korçës, numri i familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike, a ka bashkia programe për të nxitur punësimin e tyre etj	03.05.2023	Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion datë 18.04.2023, ju bëjmë me dije se: <b>1. Sa familje dhe sa anëtarë të komunitetit rom dhe egjiptian jetojnë në bashkinë e Korçës?</b> - Sipas Zyrës së Gjendjes Civile nuk disponojmë të dhëna mbi numrin e anëtarëve të këtyre komuniteteve. <b>2. Sa është numri i familjeve rome dhe egjiptiane që trajtohen me ndihmë ekonomike?</b> - Sipas informacionit të marrë nga Drejtoria e Kujdesit Social, numri i familjeve rome dhe egjiptiane që trajtohen me ndihmë ekonomike është rreth 300 familje. <b>3. A ka bashkia politika/ programe për të nxitur punësimin e romëve dhe egjiptianëve? Cilat janë ato?</b> - Sipas informacionit të marrë nga Drejtoria e Kujdesit Social, Bashkia Korçë në bashkëpunim me Drejtorinë	E plotë	S'ka tarifë

			<p>Rajonale të Shërbimit Social Korçë dhe me Drejtorinë Rajonale të Punësimit janë duke zbatuar programin e orientimit të personave nga familje që trajtohen me Ndhmë Ekonomike, ku për vitin 2023 deri tani janë punësuar rreth 15 persona. Këto programe të nxitjes së punësimit zbatohen çdo vit nga ana e Bashkisë.</p> <p><b>4. Çfarë shërbime ofrohen nga ana e bashkisë për nxitjen e punësimit për anëtarët e komunitetit Rom dhe Egjiptian? Sa është numri i të punësuarve romë dhe egjiptianë gjatë 4 viteve të fundit, si pasojë e zbatimit të programeve në ndihmë të këtyre komuniteteve?</b></p> <p>- Sipas informacionit të marrë nga Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore Bashkia Korçë është duke punuar për krijimin e projekteve të cilat synojnë nxitjen e punësimit për anëtarët e këtyre komuniteteve për aq kohë sa lejon ligji. Nuk mund të vendosim në dispozicion numrin e të punësuarve pasi është një e dhënë e cila nuk ju kërkohet nga ana e institucionit tonë.</p>	
--	--	--	--	--

			<p><b>5. A ka lehtësi fiskale për të vetëpunësuarit që i përkasin këtij komuniteti? Në rast se po, sa persona përfitojnë? Cilët janë sektorët ku janë vetëpunësuar?</b></p> <p>- Sipas informacionit të marrë nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore nuk ka lehtësi fiskale.</p> <p><b>6. Sa vendbanime informale të komunitetit Rom dhe Egjiptian ka në Bashkinë Korçë dhe ku ndodhen ato?</b></p> <p>- Sipas informacionit të marrë nga Drejtoria e Strehimit Social dhe Menaxhimit të Banesave Sociale, janë 4 vendbanime informale:  Ish UMB (3 familje);  L.6 ish "Fabrika e Duhanit" (15-20 familje);  Ish Ndërmarrja Gjeologjike ( 20 familje);  Ish Lavanteria (12 familje).</p> <p><b>7. Si ka ndikuar landfilli i Maliqit për integrimin e mbledhësve individualë të mbetjeve?</b></p> <p>- Sipas informacionit të marrë nga Drejtoria e Menaxhimit të Kontratave të Infrastrukturës dhe të Tjera, nuk ka pasur ndikim.</p> <p><b>8. A ka Bashkia Korçë projekte të cilat ndikojnë në rritjen e</b></p>	
--	--	--	---	--

			<p><b>formalizimit të tregut të punës për këtë komunitet? Nëse po cilat janë dhe si ndikojnë?</b></p> <p>- Sipas informacionit të marrë nga Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, formalizimi i tregut të punës i takon Inspektoriatit të Punës dhe mund t'i drejtoheni këtij institucioni.</p> <p><b>9. Inkubatori i Biznesit sa i shërbeu anëtarëve të këtij komuniteti në lidhje me çështjen e punësimit/vetëpunësimit dhe pse nuk funksionoi?</b></p> <p>- Sipas informacionit të marrë nga zyra përkatëse ky projekt u aplikua bashkë me RDA, organizatën Agjencia për Zhvillimin e Rajoneve. Me këtë organizatë kishim dhe një kontratë pasi Inkubatorin e Biznesit do e menaxhonin ata. Në përfundim të kontratës OJF nuk kërkoi rinovim, pasi nuk mund ta ndiqte dot më si projekt. Bashkia Korçë është duke parë mundësi të tjera për funksionimin e qendrës.</p>	
--	--	--	--	--

16.	20.05.2023	Kërkesë për t'u pajisur me informacion mbi rikonstruksionin e gjimnazit "Themistokli Gërmenji", kur pritet të mbarojnë punimet si edhe sa është kostoja.	29.05.2023	Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion datë 20.05.2023, sipas të dhënave të marra nga Drejtoria e Menaxhimit të Kontratave të Infrastrukturës dhe të tjera Bashkia Korçë, ju bëjmë me dije se: 1. Punimet u ndërprejnë për pak kohë në periudhën e dimrit për arsye të kushteve të motit. 2. Objekti përfundon në fund të muajit Qershor. 3. Vlera është 75.565.666 lekë.	E plotë	S'ka tarifë
17.	12.06.2023	Kërkesë për t'u pajisur me informacion mbi rastet e identifikuara dhe raportuara të fëmijëve në nevojë mbrojtje gjatë vitit 2022 dhe muajve Janar-Maj 2023, për sa prej rasteve të identifikuara si në nevojë është miratuar Plani Individual i Mbrojtjes, sa është fondi i buxhetit të bashkisë për vitin 2023 për mbrojtjen e fëmijëve, sa është fondi i shpenzuar nga buxheti i vitit 2022 për trajtimin e fëmijëve në nevojë.	20.06.2023	Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion datë 12.06.2023, sipas të dhënave të marra nga Drejtoria e Kujdesit Social Bashkia Korçë ju bëjmë me dije se: Gjatë vitit 2022 janë trajtuar 79 raste të fëmijëve në nevojë për mbrojtje. Gjatë tremujorit të parë të vitit 2023 janë trajtuar 13 raste. Të gjithë rastet janë trajtuar me plan individual mbrojtje. Sa i përket fondit për trajtimin e fëmijëve në nevojë për mbrojtje, Bashkia Korçë ka disa projekte që kanë si qëllim mbështetjen e fëmijëve në nevojë: - 3 qendra ditore në të cilat fëmijët bëjnë detyrat, zhvillojnë aktivitete të ndryshme, marrin një vakt ushqimor etj.	E plotë	S'ka tarifë

				<ul style="list-style-type: none"> <li>- Kampi Veror “Miqësia” në të cilën marrin pjesë 100 fëmijë çdo ditë.</li> <li>- Kitet shkollore për fëmijët në nevojë.</li> <li>- Mbështetje direkte me pako ushqimore për fëmijët në nevojë.</li> <li>- 20 nëntori- Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve.</li> <li>- Pagesa e kopshtit dhe çerdhes</li> <li>- Në varësi të nevojave pagesa e psikologut ekspert në gjykatë, etj.</li> </ul> <p>Gjatë viteve 2019-2022 Bashkia Korçë ka Planin e Mbrojtjes Sociale, i cili nuk është i buxhetuar. Aktualisht po përgatitet Plani i Ri i Mbrojtjes Sociale.</p> <p>Fondi total për këto projekte për vitin 2022 ishte 3,890,300 lekë, ndërsa për vitin 2023 është 4,046,940 lekë.</p>		
18.	21.06.2023	Kërkesë për t’u pajisur me informacion mbi numrin e shkollave në Bashkinë Korçë, numrin e nxënësve në 9-vjeçare në vitin shkollor: 2017-2018/2018-2019/2019-2020/2020-2021/2021-2022/2022-2023 si dhe numri i të regjistruarve	26.06.2023	<p>Në përgjigje të kërkesave për informacion datë 21.06.2023, sipas të dhënave të marra nga Ndërmarrja e Shërbimit Mbështetës të Arsimit dhe Çerdhes Bashkia Korçë, ju bëjmë me dije se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Numri i shkollave në qytet: 19 shkolla 9 - vjeçare dhe 1 shkollë speciale</li> <li>5 shkolla të mesme të përgjithshme</li> <li>5 shkolla të mesme profesionale</li> </ul>	E deleguar	S’ka tarifë

		për klasën e parë, numri i nxënësve në gjimnaz në vitin shkollor: 2017-2018/2018-2019/2019-2020/2020-2021/2021-2022/2022-2023 si dhe numri i të regjistruarve në vitin e parë, sa ka qenë numri i shkollave në vitin 2018, sa shkolla janë mbyllur gjatë periudhës Janar 2018-Janar 2023.		-Numri i shkollave në njësitë administrative: 36 shkolla 9 - vjeçare 1 shkollë e mesme e përgjithshme -Gjatë periudhës Janar 2018 - Janar 2023 është mbyllur një shkollë në fshatin Lavdar, njësia administrative Voskopojë. Duke qenë se Bashkia Korçë nuk zotëron informacionin për pyetjet e tjera të ngritura nga ana juaj, po e delegojmë atë pranë Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Korçë.		
19.	04.07.2023	Kërkesë për t'u pajisur me informacion mbi numrin e punësimeve të reja nga data 31 Maj 2022 deri më 31 Maj 2023 të ndarë sipas kontratave të punësimit, pozicionet në të cilat janë emëruar të punësuarit, numri i punonjësve të Bashkisë dhe institucioneve në varësi ne fund të muajit Maj 2023 si edhe të vendoset në dispozicion vendimi i emërimeve në detyrë për të gjithë të	12.07.2023	Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion datë 04.07.2023, sipas të dhënave të marra nga Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore Bashkia Korçë, ju bëjmë me dije se: 1. Numri i punësimeve të reja gjatë periudhës 31 Maj 2022 deri më 31 Maj 2023 është 61 emërimë, prej të cilave 4 me kontrata pune të përkohshme dhe 57 me kontrata pune të përhershme. 2.Të punësuarit gjatë periudhës kohore 31 Maj 2022-31 Maj 2023 janë emëruar në pozicionet si më poshtë:	E plotë	S'ka tarifë

		<p>punësuarit gjatë kësaj periudhe kohore.</p>	<p>4 Kujdestare tek Shtëpia e Foshnjës;  1 Rojtar Pyjesh;  1 Inspektor për inspektimin dhe mbrojtjen e pyjeve;  1 Specialist Projektues;  1 Specialist Logjistike;  2 Specialist për IT;  1 Përgjegjës për Sektorin IT;  1 Përgjegjës për Sektorin e Emergjencave Civile;  1 Specialist për Barazinë Gjinore;  1 Specialist për Sektorin e Strehimit Social;  1 Specialist për Kadastrën Fiskale;  1 Përgjegjës për Kadastrën Fiskale;  1 Specialist Agronom;  1 Mbikqyrës në Sektorin e Bujqësisë;  4 Police Bashkiakë;  4 Magazinierë;  1 Mbikqyrës Pastrimi;  2 Sanitare;  2 Punëtorë;  1 Psikologe;  1 Aktor pranë Qëndres të Artit dhe Kulturës;  2 Këshilltarë të Kryetarit të Bashkisë;  1 Dizenjator;  2 Specialiste për Marrëdhënien me Publikun;  4 Punonjës të parkimit me pagesë;</p>		
--	--	--	---	--	--

			<p>1 Drejtore e Klubit Shumësportësh;  1 Menaxher teknik i rekrutimit të sportistëve;  2 Logopediste;  1 Përgjegjës për Gjendjen Civile;  3 Punonjës të Gjendjes Civile;  1 Bibliotekiste;  1 Protokoll-Arkivuese;  1 Llogaritare;  1 Specialist për Performancën;  1 Specialist per Artin;  1 Administrator i Njësie Administrative;  1 Përgjegjës per Marrëdhënien me Publikun;  1 Specialist për kontabilitetin;  1 Specialist për Sektorin e Pagave;  2 Specialistë për ndihmën ekonomike.</p> <p>3. Numri i punonjësve, pjesë e Bashkisë dhe institucioneve në varësi deri në fund të muajit Maj 2023 është 1131.</p> <p>4. Vendimet e emërimeve të të punësuarve me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme nuk mund t'jua vendosim në dispozicion pasi ato janë akte personale të të punësuarve dhe ndodhen në dosjet e secilit.</p>	
--	--	--	---	--

20.	07.07.2023	Kërkesë për t'u pajisur me informacion nëse ka pasur bashkia buxhet vjetor të planifikuar për rininë për periudhën janar-dhjetor 2022, nëse po sa përqind të shumës zënë këto zëra, a ka të punësuar pranë bashkisë individë të moshës 18-29 dhe sa prej tyre janë femra sa meshkuj, sa është përqindja e të rinjve të punësuar krahasuar me numrin total të administratës etj	12.07.2023	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion datë 07.07.2023, ju bëjmë me dije se:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Buxheti për rininë nuk buxhetohet më vete, por vlera e tij përcaktohet në bazë të programeve buxhetore për çdo njësi shpenzuese të specifikuar nga Bashkia Korçë për projektet që zbatohen, konkretisht: Programi i Arsimit Bazë; Programi i Arsimit të Mesëm të Përgjithshëm; Programi i Arsimit Profesional; Programi Sport dhe Argëtim ku përfshihen të rinjtë.</li> <li>2. Aktualisht janë të punësuar 42 punonjës të cilët i përkasin grupmoshës 18-29 vjeç (22 meshkuj dhe 20 femra).</li> <li>3. Përqindja e të rinjve të punësuar krahasuar me numrin total të administratës është 15.7%.</li> <li>4. Bashkia Korçë e konsideron rininë si një nga prioritetet kryesore, duke krijuar ura bashkëpunimi me institucione dhe organizata jo-fitimprurëse. Bashkëpunimi me këto organizata ka bërë të mundur hartimin dhe implementimin e projekteve për t'ju dhënë zgjidhje problematikave lokale rinore. Gama e mbështetjes së të rinjve nga ana e bashkisë është e gjerë dhe kap shumë</li> </ol>	E plotë	S'ka tarifë
-----	------------	--	------------	---	---------	-------------

			<p>dimensione si: nxitja për punësim, edukimi, sporti, kultura, vullnetarizmi etj. Qendra Sportive Korçë është një tjetër hapësirë multifunksionale, ku të rinjtë e grupmoshave të ndryshme zhvillojnë talentet e tyre në një gamë të gjerë disiplinash sportive. Vlen të përmendet investimi më i fundit i Bashkisë Korçë, Korça Innovation Technology Hub, ku zhvillohen kurse, trajnime në fushën e programimit, teknologjisë dhe menaxhimit të rrjeteve sociale. Ky Hub u ofron mundësi të rinjve për t'u kualifikuar dhe më pas të punësohen në këtë treg në botën digjitale.</p> <p>Plani Lokal i Veprimit për Rininë është hartuar në bashkëpunim me Bashkinë Korçë, falë mbështetjes së plotë të Fondacionit Friedrich Ebert, i cili mbështet zhvillimin e politikave rinore në nivel vendor dhe qendror, në bashkëpunim me Kongresin Rinor Kombëtar. Ky plan shërben si një bazë orientuese politikash dhe veprimtarish të dedikuara për sektorin e rinisë, në përputhje të plotë me perceptimet dhe vizionin që të rinjtë dhe institucionet kanë mbi perspektivën lokale.</p>		
--	--	--	---	--	--

			<p><a href="https://www.fes-tirana.org/fileadmin/user_upload/documents/Plani_lokal_i_veprimit_per_rinine_2020-2023_Korce.pdf">https://www.fes-tirana.org/fileadmin/user_upload/documents/Plani_lokal_i_veprimit_per_rinine_2020-2023_Korce.pdf</a></p> <p>Plani Lokal i Veprimit per Rininë është fokusuar në 6 prioritete, që janë përcaktuar si prioritete të rëndësishme edhe për Bashkinë Korçë, të cilat janë:</p> <ol style="list-style-type: none"><li>1- Arsimi cilësor dhe gjithëpërfshirës;</li><li>2- Punësimi dhe sipërmarrja rinore;</li><li>3- Pjesëmarrja dhe përfaqësimi rinor;</li><li>4-Art, sport, kulturë dhe mjedis;</li><li>5- Mbështetja e organizatave dhe nismave rinore;</li><li>6- Çështjet sociale, shëndetësore dhe shërbimet publike për të rinjtë.</li></ol> <p>5 - 6. Bashkia Korçë ka ngritur Këshillin Vendor të Rinisë me vendim të Këshillit Bashkiak Nr.122 datë 29/07/2022. Krijimi i një vendi të dedikuar për rininë (Janar 2021) brenda Kabinetit të kryetarit të bashkisë është një tregues për rëndësinë e kësaj grupmoshe në prioritetet e bashkisë. Përmendim sektorin e teknologjisë dhe inovacionit i cili është i dedikuar në trajnimin dhe</p>	
--	--	--	---	--

			<p>punësimin e të rinjve në fushën e përmendur.</p> <p>8. Për të gjitha aktivitetet rinore, proceset konsultative, projektet me në fokus rininë të listuara më sipër Bashkia Korçë bashkëpunon me institucione/organizata në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar.</p> <p>Përmendim disa prej tyre:</p> <p>Nivel kombëtar: Drejtoria Rajonale e Shërbimit Kombëtar të Punësimit Korçë, institucione të tjera publike, organizata të tjera lokale apo kombëtare të interesuara për të zhvilluar aktivitete të përbashkëta dhe ministritë e linjës.</p> <p>Nivel ndërkombëtar: UNDP, Terre des Homes, UNICEF, USAID, World Vision, Eu4Innovation etj</p> <p>Përmendim aktivitetet:</p> <p>Projekti “Bursa për gjimnazistët”, që konsiston në vlerësimin moral dhe financiar të nxënësve ekselente nga gjimnazet e Bashkisë Korçë.</p> <p>Projekti “Parku me materiale të riciklueshme” , që synon angazhimin e të rinjve të shkollave që të zbatojnë idetë e tyre inovative.</p> <p>Projekti “Idea Bombing”, që synon organizimin e një konkursi ku të rinjtë pjesëmarrës kanë mundësi të japin zgjidhje, ide apo të ngrenë</p>		
--	--	--	---	--	--

			<p>problematika që kërkojnë zgjidhje për qytetin e Korçës.</p> <p>Projekti “Upshift” është një program i cili ka si qëllim rritjen e mundësive për të rinjtë duke siguruar rritjen e mirëqenies nëpërmjet punësimit dhe sipërmarrjes. Ky program përmirëson gatishmërinë profesionale dhe kapacitetet e sipërmarrjes, për sa i përket aftësive të transferueshme dhe eksperiencave profesionale tek të rinjtë.</p> <p>Projekti “iKorça Hackathon” u organizua nga Bashkia Korçë, me mbështetjen e projektit “EU for Innovation” dhe në bashkëpunim me ICTSlab dhe Crazy Town. Rreth 40 studentë, kërkues nga universitete, anëtarë të stafit akademik, Startup-e dhe talente të tjera u bashkuan nga data 11-13 dhjetor virtualisht dhe fizikisht për ekipet që vinin nga Korça. Eventu u mbajt në bibliotekën e re të qytetit, e cila tashmë është shndërruar në Korça ICT Hub. Gjatë Hackathon u prezantuan një seri shërbimesh, konceptesh, aplikacionesh, demosh dhe kërkimesh.</p> <p>Projekti “Agrichallenge” është një konkurs i organizuar nga Zhvillimi</p>		
--	--	--	--	--	--

			<p>i Qëndrueshëm Rural në Shqipëri (SRD), i cili zbatohet në Shqipëri nga GIZ në bashkëpunim me Ministrinë Shqiptare të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Bashkinë Korçë dhe financuar nga Qeveria Gjermane (Ministria Federale Gjermane e Bashkëpunimit dhe Zhvillimit Ekonomik). Qëllimi kryesor i këtij programi është promovimi i aftësive sipërmarrëse tek të rinjtë në kuadër të përmirësimit të bujqësisë dhe agroturizmit në Qarkun e Korçës. AgriChallenge nis si një seri ngjarjesh dhe aktivitësh edukative, të përbërë nga seminare të ndryshme, kampe pune, të cilat finalizohen me Hackathone nën "AgriChallenge", për të mbështetur perspektivat e diversifikuara të të ardhurave në agroturizëm, agrobiznes dhe për të përmirësuar konkurrencën në sektorin e bujqësisë.</p> <p>Projekti "Ponder" është një program social - rinor nga UNICEF Albania në bashkëpunim me ICTSlab dhe mbështetjen e Bashkisë Korçë. Ky program ka si qëllim të nxisë tek të rinjtë aftësinë e të menduarit kritik, veçanërisht në lidhje me informacionet që</p>		
--	--	--	--	--	--

				<p>marrin nga të gjitha llojet e mediave.</p> <p>Të rinj nga e gjithë Shqipëria janë bërë pjesë e një prej akademive më të mëdha të inovacionit në vendin tonë, “Korça ICT Academy”. Në kuadër të bashkëpunimit të Bashkisë Korçë dhe partnerë të tjerë, 110 të rinj i janë bashkuar kampit veror të kodimit në Korçë, ku nën drejtimin e 12 instruktorëve amerikanë nga Universiteti i Stanford mësojnë se si të programojnë në Python dhe Android dhe se si të zbatojnë me efikasitet të menduarit kritik.</p> <p>9. Përqindja e të rinjve në konsultimet publike është afërsisht 30%. Njoftimi i të rinjve bëhet nëpërmjet rrjeteve tona sociale si edhe faqes zyrtare të web-it.</p>		
21.	07.07.2023	Kërkesë për t’u pajisur me informacion nëse është vënë në zbatim Plani Vendor i Veprimit për vitin 2019-2022 i hartuar nga bashkia për integrimin e komunitetit rom dhe egjiptian, çfarë ka bërë konkretisht bashkia për rritjen e punësimit të	18.07.2023	<p>Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion datë 07.07.2023, sipas të dhënave të marra nga Drejtoria e Kujdesit Social Bashkia Korçë, ju bëjmë me dije se:</p> <p>1. A është vënë në zbatim Plani Vendor i Veprimit për vitin 2019-2022 i hartuar nga Bashkia Korçë për integrimin e komunitetit rom dhe egjiptian?</p> <p>Po, Plani Vendor i Veprimit është vënë në zbatim për periudhën</p>	E plotë	S’ka tarifë

		<p>tyrë, sa është numri i të punësuarve të tyre, politikat që ka ndërmarrë bashkia për rritjen e punësimit për këto kategori etj</p>	<p>2019-2022 për gjithëpërfshirjen e komunitetit rom dhe egjiptian.</p> <p>2. Çfarë ka bërë konkretisht bashkia për rritjen e punësimit për romët dhe egjiptianët? Bashkia Korçë në bashkëpunim me Zyrën e Punës nëpërmjet programeve të nxitjes së punësimit ka punësuar për një periudhë 1-vjeçare 14 persona nga komuniteti rom dhe egjiptian. Personat kryejnë: -punë në komunitet me orar të reduktuar, -paguhen me gjysmën e pagës minimale, por pa u shkëputur nga trajtimi me ndihmë ekonomike.</p> <p>3. Sa është numri i të punësuarve të kësaj kategorie gjatë periudhës së zbatimit të këtij plani dhe në vazhdim? -Në total për periudhën kohore 2019-2022 janë 77 persona nga komuniteti rom dhe egjiptian, të cilët janë punësuar dhe kanë ndjekur kurset e formimit profesional. -Nga programet e nxitjes së punësimit janë 3 persona të punësuar. -Të punësuar në total përgjatë 3 viteve janë 270 persona nga komuniteti rom dhe egjiptian.</p>		
--	--	--	---	--	--

			<p>(Informacion i marrë nga Zyra e Punës)</p> <p>4. Cilat janë projektet konkrete që ka zbatuar Bashkia Korçë për rritjen e punësimit të romëve dhe egjiptianëve?</p> <p>Bashkia Korçë në bashkëpunim me Zyrën e Punës ka punësuar 14 persona nga komuniteti rom dhe egjiptian, të cilët punojnë me orar të reduktuar dhe paguhen me gjysmën e pagesës minimale për një periudhë 1-vjeçare.</p> <p>Nxitja e të rinjve dhe familjeve të reja drejt punësimit pa i shkëputur nga skema e ndihmës ekonomike.</p> <p>Sa prej tyre janë financuar nga bashkia dhe sa është vlera e financimit?</p> <p>Nuk disponojmë informacion.</p> <p>Sa prej projekteve i ka financuar qeveria dhe sa është vlera e financimit?</p> <p>Nuk disponojmë informacion.</p> <p>Sa projekte për rritjen e punësimit të romëve dhe egjiptianëve janë financuar nga donatorë dhe sa është vlera e financimit?</p> <p>Nuk disponojmë informacion.</p> <p>5. A ka ndërmarrë bashkia politika lehtësuese për rritjen e punësimit tek këto kategori sipas angazhimeve të marra vetë prej saj?</p>		
--	--	--	--	--	--

			<p>-Një nga politikat që është ndërmarrë në lidhje me punësimin është punësimi i personave të komunitetit rom dhe egjiptian pa shkëputje nga skemat e ndihmës ekonomike për sa kohë ata janë të punësuar dhe e deklarojnë atë.</p> <p>-Një nga politikat e tjera lehtësuese është edhe reduktimi nga tarifat e kopshteve dhe çerdheve për fëmijët e komunitetit rom dhe egjiptian, nëse prindërit i kanë në marrëdhënie pune ose ndjekin një kurs profesional.</p> <p>6. Cilët nga indikatorët e Planit Vendor të Veprimit për integrimin e romëve dhe egjiptianëve janë realizuar?</p> <p>Disa nga indikatorët e realizuar në Planin e Veprimit:</p> <p>Arsimi</p> <p>Në fushën e arsimit janë mbështetur financiarisht fëmijët që i përkasin komunitetit rom dhe egjiptian të cilët jetojnë në vështirësi ekonomike nëpërmjet bursave, kiteve shkollore dhe përjashtimi nga tarifat e kopshteve dhe çerdheve.</p> <p>Përmirësimi i infrastrukturave të disa shkollave fillore, ku mund të përmëndim shkollën “Naim</p>		
--	--	--	--	--	--

			<p>Frashëri” dhe shkollën “Nuci Naci”.</p> <p><b>Punësimi</b> Janë punësuar 14 persona nga komuniteti rom dhe egjiptian për punë me orar të reduktuar në komunitet. Janë zhvilluar aktivitete ndërgjegjësuese për punësimin me të rinjtë nga komuniteti, gjithashtu të rinjtë cilët kanë mbaruar arsimin 9-vjeçar kanë mundësi të ndjekin kurset profesionale për të qenë sa më afër tregut të punës.</p> <p><b>Strehimi</b> Është ndërhyrë në restaurimin e banesave private dhe kolektive gjatë kësaj periudhe për familjet në nevojë pa të ardhura që i përkasin komunitetit rom dhe egjiptian. Përfitues gjithashtu ka edhe nga programi i subvencionimit të qiras, por problem ngelet lidhja e kontratave me qiradhënësit</p> <p>-Është kryer një ndërhyrje në rrjetin e infrastrukturës së kanalizimeve në ujrat e përdorura tek ish-gjeologjia, pengesë për ndërhyrje afatgjate është trualli dhe banesat janë me ish-pronar.</p> <p>-Një pengesë tjetër e cila nuk lejon ndërhyrjen për restaurim në këto banesa është edhe mungesa e dokumentacionit të pronësisë.</p>		
--	--	--	---	--	--

				<p>-Nga programi i banesave sociale me qira për vitin 2021 janë 2 familje egjiptiane.</p> <p>-Familjet përfituese nga subvencionimi i qiras për vitin 2021 janë 6 familje egjiptiane.</p> <p><b>Shëndetësia</b></p> <p>Nga statistikat personat nga komuniteti rom dhe egjiptian janë të gjithë të vaksinuar dhe i kanë kryer kontrollet e duhura mjekësore. Gjendja higjeno-sanitare është paraqitur e qëndrueshme nga vizitat e mjekëve në familje, por ka edhe raste shumë të rralla që nuk i plotësojnë kushtet bazike higjeno-sanitare.</p> <p>-Të dhënat që janë mbledhur tregojnë se të gjithë anëtarët e komunitetit me përjashtim të rasteve të rralla janë të vaksinuar.</p> <p>-Paketën e shërbimit që marrin për vaksinim.</p> <p>-Në vitin 2021 janë 4.934 femra dhe 4.856 meshkuj</p> <p>-Në vitin 2020 janë 4.935 femra dhe 4.727 meshkuj</p> <p>-Në vitin 2021 janë nga mosha 0 deri në 5 vjeç 565 persona</p> <p>-Nga mosha 5 deri 10 vjeç janë 582 persona që përfitojnë shërbimin shëndetësor.</p>	
--	--	--	--	---	--

			<p>Migrimi</p> <p>Një nga fushat e tjera është edhe Migrimi, Aktivizimi dhe pjesëmarrja në vendimmarrje. Vëmendje u është dhënë edhe familjeve që janë kthyer nga emigrimi. Është bërë vlerësimi i nevojave dhe u është ardhur në ndihmë nëpërmjet ofrimit të punëve nga Zyra e Punës. Është dhënë ndihmes nga koordinatori i qendrës komunitare për regjistrimin e fëmijëve në Gjëndjen Civile, për ata femijë të cilët kanë qenë të paregjistruar në shkolla etj.</p> <p>Çdo vit janë realizuar 2 projekte për komunitetin rom dhe egjiptian të financuara nga Bashkia Korçë “8 Prilli Dita Ndërkombëtare e Komunitetit Rom” dhe “24 Qershori Dita e Egjiptianëve të Ballkanit”.</p> <p>7. Cilët indikatorë nuk janë përmbushur dhe cilat janë arsyet? Arsyet që kemi mospërmbushje të disa pikave në Planin e Veprimit janë:</p> <p>-Mungesa e një database nga instucionet të cilat nuk i kanë të ndara komunitetet në rom dhe egjiptian,</p>	
--	--	--	---	--

				<p>-Mosdeklarimi i anëtarëve të komunitetit se kujt etnie i përkasin është një tjetër problem që hasin institucionet.</p> <p>8. Plani vendor i veprimit 2019-2022 parashikon një kosto prej 2.3 milion euro. A e ka siguruar Bashkia e Korçës fondin e parashikuar në Planin e Veprimit dhe si është përdorur ky fond? Nuk disponojmë informacion.</p> <p>9. Po fondi i parashikuar në Planin Vendor të Veprimit në ngarkim të qeverisë është siguruar? Nese po, në ç'masë? Dhe çfarë projektesh janë realizuar me këtë fond? Nuk disponojmë informacion.</p>		
22.	25.07.2023	Kërkesë për t'u pajisur me informacion mbi fondin në dispozicion për vitin 2023 për emergjencat civile në Bashkinë Korçë, sa ka qenë ky fond në vitin 2020,2021 dhe 2022, cili është kapaciteti i bashkisë për emergjencat civile, a ka bashkia kapacitete të mjaftueshme për të përballuar fatkeqësitë natyrore si dhe sa është mbështetja financiare e	03.08.2023	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion datë 25.07.2023, sipas të dhënave të marra nga Drejtoria e Përgjithshme e Financës, Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, si dhe nga Sektori i Emergjencave Civile, ju bëjmë me dije se:</p> <p>- Sa është fondi në dispozicion për vitin 2023 për emergjencat civile në Bashkinë Korçë?</p> <p>Për vitin 2023 fondi i emergjencave civile është 38,367,555 lekë, nga të cilat 32,010,535 lekë nga buxheti qëndror dhe 6,357,020 lekë nga buxheti i bashkisë.</p>	E plotë	S'ka tarifë

		<p>marrë nga pushteti qendror për këtë vit për emergjencat civile.</p>	<p>- Sa ka qenë ky fond në vitin 2020, 2021 dhe 2022?  Për vitin 2022 fondi ishte 70,355,587 lekë nga të cilat 66,578,587 lekë nga buxheti qendror dhe 3,777,000 lekë nga buxheti i bashkisë.  Për vitin 2021 fondi ishte 7,876,875 lekë nga të cilat 3,829,735 lekë nga buxheti qendror dhe 4,047,140 lekë nga buxheti i bashkisë.  Për vitin 2020 fondi ishte 32,348,276 lekë nga të cilat 5,022,209 lekë nga buxheti qendror dhe 27,326,067 lekë nga buxheti i bashkisë.  - Cili është kapaciteti i bashkisë për emergjencat civile (punonjës, pajisje teknike, logjistike etj)?  Gjithë territori i Bashkisë Korçë për emergjencat civile sipas një plani të përgatitur më parë mbulohet nga 195 punonjës (kryesisht të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, në varësi të Bashkisë Korçë), si edhe 29 punonjës të Drejtorisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit (MZSH).  Në raste situatash të vështira në bazë të ligjit Nr. 45/2019 "Për Mbrojtjen Civile", do të veprojnë edhe Forcat Operacionale të</p>		
--	--	--	---	--	--

			<p>dislokuara në territorin e Bashkisë Korçë, konkretisht: Komanda e Mbështetjes Rajonale, Komisariati i Policisë, Stacioni i MZSH-së, Shërbimi i Urgjencës Mjekësore dhe Shërbimi i Vullnetarëve për Mbrojtjen Civile.</p> <p>Mjete në dispozicion të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, për emergjencat civile janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 5 (pesë) fadroma;</li> <li>- 2 (dy) borëpastruese;</li> <li>- 5 (pesë) mjete të tjera me huapërdorje;</li> </ul> <p>Stacioni i MZSH-së ka këto paisje:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 7 (shtatë) automjete zjarrëfikës;</li> <li>- 4 (katër) automjete për shuarjen e zjarrit me kalueshmëri të lartë 4x4;</li> <li>- 2 (dy) automjete shpëtimi me paisje.</li> </ul> <p>- A ka bashkia kapacitete të mjaftueshme për të përballuar fatkeqësitë natyrore të tilla si zjarre, përmytje, tërmetet etj.?</p> <p>Nisur nga situatat që janë kaluar nga fatkeqësitë natyrore që kanë prekur territorin e bashkisë, mendojmë se i kemi kapacitetet e nevojshme për të përballuar fatkeqësitë natyrore që mund të prekin territorin në administrim.</p>	
--	--	--	--	--

				- Sa është mbështetja financiare e marrë nga pushteti qendror për këtë vit për emergjencat civile? Mbështetja financiare nga pushteti qendror për vitin 2023 është 32,010,535 lekë.		
23.	29.07.2023	Kërkesë për t'u pajisur me informacion mbi numrin total të familjeve/individëve që trajtohen me ndihmë ekonomike si dhe numri total i familjeve që përfitojnë nga ndihma bllok 6%.	02.08.2023	Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion datë 29.07.2023 sipas të dhënave të marra nga Drejtoria e Kujdesit Social, ju bëjmë me dije se: 1. Numri total i familjeve/individëve që trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin Qershor 2023 është 762 familje/individë. 2. Për muajin Qershor 2023 përfitojnë nga bllok ndihma e 6% të fondit të kushtëzuar 63 familje/individë.	E plotë	S'ka tarifë
24.	13.09.2023	Kërkesë për t'u pajisur me informacion për investimet në rrugët Lekas-Voskopojë dhe Voskopojë-Krushovë si: në çfarë faze janë punimet për rehabilitimin e rrugëve, sa km është secila rrugë, vlera totale e investimit, kur pritet të përfundojnë etj si edhe informacion mbi	26.09.2023	Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion datë 13.09.2023, ju bëjmë me dije se: 1. Sipas të dhënave të marra nga Njësia Administrative Lekas dhe Voskopojë, Rruga Lekas-Voskopojë ka përfunduar me rehabilitimin e saj. Kjo rrugë është e gjatë 19 km dhe punimet po kryhen nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, nuk është investim por mirëmbajtje dhe sistemim i rrugës me çakull në	E plotë	S'ka tarifë

		<p>investimin per mini impiant të trajtimit të ujërave të ndotura në fshatin Melçan, në çfarë fazë është, sa është vlera e investimit etj. Gjithashtu është kërkuar informacion mbi resortin dimëror SKIPISTA si edhe aeroportin turistiko-sportiv në Korçë.</p>		<p>pjesët e dëmtuara të saj. Sa i takon rrugës Krushovë-Voskopojë punimet për rehabilitimin e rrugës kanë përfunduar. Kjo rrugë është e gjatë rreth 7 km dhe punimet janë kryer nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike. Këto punime janë kryer vetëm në pjesët e dëmtuara të rrugës.</p> <p>2. Sipas të dhënave të marra nga Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë Sh.A, investimi ka filluar prej muajit Prill 2023 dhe projekti përfshin rrjetin e brendshëm të shkarkimit të ujërave të përdorura, pikë-lidhjet me objektet, kolektor kryesor dhe mini impiant trajtimi mekanik. Projekti në fshatin Melçan është në përfundim të punimeve. Projekti konkret u realizua midis furnizimit me materiale të FSHZH dhe zbatimit të punimeve nga UKRK SH.A. Vetëm vlera e punimeve shkon 8.500.000 lekë. Pjesa e rrjetit të kanalizimeve ka përfunduar.</p> <p>3. Në lidhje me skipistën, Bashkia Korçë është në biseda me donatorë dhe investitorë potencialë për identifikimin e vendit më të përshtatshëm për zhvillimin e këtij sporti dimëror.</p>	
--	--	--	--	--	--

				4. Sipas të dhënave të marra nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, për aeroportin turistiko-sportiv po punohet ende. Vlera e objektit është 99.999.999 lekë. Ky projekt financohet nga FSHZH-ja dhe afati për kryerjen e punimeve është 18 muaj nga nisja e punimeve.		
25.	15.09.2023	Kërkesë për t'u pajisur me informacion mbi sipërfaqen e tokës bujqësore në bashkinë Korçë, sa ha nga kjo sipërfaqe është e mbuluar me sistem vaditës, sa është funksionale, si është gjendja e infrastrukturës kulluese, etj	28.09.2023	Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion datë 15.09.2023 nga informacionet e marra nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Bashkia Korçë, ju bëjmë me dije se: 1. Sipërfaqja e tokës bujqësore në Bashkinë Korçë është 20 328 ha. 2. Sipërfaqja e mbuluar me sistem ujitës është 5 566 ha. 3. Sipërfaqja e mbuluar me sistem ujitës funksional është 4 856 ha. 4. Nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike janë kryer çdo vit shërbime për pastrimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit ujitës dhe kullues duke ndërhyrë dhe me vendosje tombino betoni të përmasave të ndryshme. Shërbimet janë kryer në të gjithë fshatrat e Bashkisë Korçë me përjashtim të disa fshatrave të pabanuar në zonat e thella malore ku nuk ka qenë e nevojshme.	E plotë	S'ka tarifë

			<p>Gjendja e infrastrukturës kulluese është në rregull në të gjithë bashkinë, sepse mirëmbahet çdo vit nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Korçë. Kjo vlen dhe për të gjithë zonën malore në Bashkinë Korçë.</p> <p>Vlerat në investimin e tombinove të betonit për vitet 2021-2023 janë si më poshtë:</p> <p>Viti 2021 - 2,882,760 lek Viti 2022 - 4,582,268 lek Viti 2023 - 3,000,000 lek</p> <p>5. Për vitin 2023 nuk janë parashikuar investime në buxhet për sistemin e vaditjes.</p> <p>6. Mungesë kullimi nuk ka në asnjë prej fshatrave të Bashkisë Korçë.</p> <p>7. Janë kryer çdo vit investime, si dhe nga ana e Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike bëhet mirëmbajtje e të gjithë rrjetit kullues.</p> <p>8. Në disa fshatra si: Kuç, Belorta, Neviçisht, Dishnicë, Malavec nuk plotësohen të gjitha nevojat për ujitje. Kjo për arsye sepse këto toka ujiteshin me kanalin e Ventrokut i cili e merrte ujin prej liqenit të Prespës. Këto fshatra plotësojnë nevojat e ujitjes për ujitjen e parë dhe të dytë nëpërmjet depozitimeve</p>	
--	--	--	---	--

				të kanalit të Ventrokut i cili për momentin shërben vetëm si depozitë. Në fshatrat malorë si Dishnica, Mborja, Lubonja, Vithkuqi, Panariti, Lavdari, etj ujitja bëhet duke shfrytëzuar ujërat e lira të përrenjve dhe ato të rezervuarëve të ndërtuar në këto zona.		
26.	20.10.2023	Kërkesë për t'u pajisur me informacion mbi bazat ligjore mbi të cilat funksionon institucioni i Bashkisë Korçë.	31.10.2023	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion datë 20.10.2023, sipas informacioneve të marra nga Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, po ju vendosim në dispozicion bazën ligjore mbi të cilën funksionon Bashkia Korçë:</p> <p>Në mbështetje të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 8 pika 2, neni 9, pika 1.1, shkronja "b" neni 64 shkronja "a" dhe "j"; Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 për "Vetëqeverisjen vendore"; Ligjit nr.152/2013 datë 30.05.2013 për "Nëpunësin civil", i ndryshuar; Ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; Ligjit nr.44/2015, datë 30.04.2015 "Kodi i Procedurave</p>	E plotë	S'ka tarifë

			<p>Administrative i Republikës së Shqipërisë”;</p> <p>Ligjit nr.9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”;</p> <p>Ligjit nr.9367, datë 07.04.2005 për “Parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”(i ndryshuar);</p> <p>Ligjit nr.119/2014, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit mbi dokumentat zyrtare”;</p> <p>Ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 për “Mbrojtjen e të dhënave personale” (i ndryshuar);</p> <p>Ligjin nr.107/2016, datë 27.10.2016 “Për Prefektin”;</p> <p>Ligjit nr.90/2012, date 27.09.2012 për “Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore;</p> <p>Ligjit nr.138/2015, datë 17.12.2015 për “Garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”;</p> <p>Ligjit nr.9636, datë 06.01.2006 për “Mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit” (i ndryshuar);</p> <p>Vendimit të Këshillit Ministrave nr.115, datë 05.03.2014 për “Përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e</p>		
--	--	--	---	--	--

			<p>vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”;</p> <p>Vendimit të Këshillit Ministrave nr. 568, datë 06.10.2021 “Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë dhe kompensimin e tyre në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore;</p> <p>Vendimit të Këshillit Ministrave nr.229, datë 23.04.2004 për “Miratimin e ceremonialit zyrtar të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar;</p> <p>Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.390, datë 06.08.1993 “Për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjen e vulave zyrtare”;</p> <p>Udhëzimit nr.1 datë 02.04.2014 për “Elementët kryesorë proceduralë dhe material të ecurisë dhe shqyrtimit të shkeljes disiplinore”;</p> <p>Ligjin 9936/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;</p> <p>Ligjin nr.68/2017 “Per financat e vetëqeverisjes vendore”;</p> <p>Ligjin nr. 9632/2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar;</p>		
--	--	--	---	--	--

				<p>Ligji Nr.9920/2008 “Per procedurat tatimore në RSH” i ndryshuar;  Ligjin Nr.114/2015 ‘Për auditimin e brendshëm në sektorin publik’;  Ligjin nr 10129/2009 “Për gjëndjen civile” dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 874 datë 29.09.2021  ”Për miratimin e rregullave për zbatimin e parimeve të etikës, të klasifikimit të veprimtarive të jashtme dhe vlerën e dhuratave që mund të pranohen gjatë veprimtarisë së nëpunësit të administratës publike”.</p>		
27.	27.10.2023	<p>Njësoj si kërkesa me nr. rendor 26 është depozituar kërkesa për t’u pajisur me informacion mbi bazat ligjore mbi të cilat funksionon institucioni i Bashkisë Korçë.</p>	31.10.2023	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion datë 27.10.2023, sipas informacioneve të marra nga Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, po ju vendosim në dispozicion bazën ligjore mbi të cilën funksionon Bashkia Korçë:  Në mbështetje të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 8 pika 2, neni 9, pika 1.1, shkronja “b” neni 64 shkronja “a” dhe “j”;  Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen vendore”;  Ligjit nr.152/2013 datë 30.05.2013 për “Nëpunësin civil” ,i ndryshuar;</p>	E plotë	S’ka tarifë

				<p>Ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligjit nr.44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; Ligjit nr.9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”; Ligjit nr.9367, datë 07.04.2005 për “Parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”(i ndryshuar); Ligjit nr.119/2014, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit mbi dokumentat zyrtare”; Ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 për “Mbrojtjen e të dhënave personale” (i ndryshuar); Ligjin nr.107/2016, datë 27.10.2016 “Për Prefektin”; Ligjit nr.90/2012, date 27.09.2012 për “Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore; Ligjit nr.138/2015, datë 17.12.2015 për “Garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”; Ligjit nr.9636, datë 06.01.2006 për “Mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit” (i ndryshuar);</p>	
--	--	--	--	--	--

			<p>Vendimit të Këshillit Ministrave nr.115, datë 05.03.2014 për “Përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”;</p> <p>Vendimit të Këshillit Ministrave nr. 568, datë 06.10.2021 “Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë dhe kompensimin e tyre në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore;</p> <p>Vendimit të Këshillit Ministrave nr.229, datë 23.04.2004 për “Miratimin e ceremonialit zyrtar të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar;</p> <p>Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.390, datë 06.08.1993 “Për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjen e vulave zyrtare”;</p> <p>Udhëzimit nr.1 datë 02.04.2014 për “Elementët kryesorë proceduralë dhe material të ecurisë dhe shqyrtimit të shkeljes disiplinore”;</p>		
--	--	--	---	--	--

				<p>Ligjin 9936/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;  Ligjin nr.68/2017 “Per financat e vetëqeverisjes vendore”;  Ligjin nr. 9632/2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar;  Ligji Nr.9920/2008 “Per procedurat tatimore në RSH” i ndryshuar;  Ligjin Nr.114/2015 ‘Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”;  Ligjin nr 10129/2009 “Për gjëndjen civile” dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 874 datë 29.09.2021 ”Për miratimin e rregullave për zbatimin e parimeve të etikës, të klasifikimit të veprimtarive të jashtme dhe vlerën e dhuratave që mund të pranohen gjatë veprimtarisë së nëpunësit të administratës publike”.</p>		
28.	01.12.2023	<p>Kërkesë për t’u pajisur me informacion nëse ka Bashkia Korçë një plan masash për trajtimin e godinave që përmbajnë materiale eterniti, a ka një inventar të godinave të banimit apo shërbimit që përmbajnë këto materiale, a ka VKM urdheresa te posacme</p>	12.12.2023	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion datë 01.12.2023, ju bëjmë me dije se:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Bashkia Korçë nuk ka një plan masash për trajtimin e godinave që përmbajnë material eterniti.</li> <li>2. Bashkia Korçë nuk ka një inventar të godinave të banimit apo shërbimit që përmbajnë këto materiale.</li> <li>3. Në dijeninë tonë nuk ka specifikime në legjislacion që</li> </ol>		

		që përcaktojnë rolin e bashkive në trajtimin e kësaj problematike, a ka inventar të ujësjellësave që përdorin ende tubo eterniti dhe në çmasë janë këto tubo të përdorur, a ka në Bashkinë Korçë një ndërmarrje publike apo private që ka lejë për largimin dhe trajtimin e këtyre mbetjeve.		përcakton rolin e bashkive në trajtimin e kësaj problematike. 4. Për këtë pyetje po presim ende informacion nga UKKO Sh.A. 5. Nuk ka në Bashkinë Korçë as ndërmarrje publike dhe as private që të ketë leje të posaçme për largimin dhe trajtimin e këtyre mbetjeve.		
29.	04.12.2023	Kërkesë për t'u pajisur me kopjet e planeve të mbarështimit të hartuara nga kompania "Abkons".	04.12.2023	Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion datë 04.12.2023, sipas të dhënave të marra nga Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave në Bashkinë Korçë, ju bëjmë me dije se planet e mbarështimit nuk mund t'ju vihen në dispozicion pasi nuk janë miratuar.	E plotë	S'ka tarifë
30.	04.12.2023	Kërkesë për t'u pajisur me informacion sa para ka shpenzuar Bashkia për dekorimin e qytetit në dhjetorin e vitit 2023 (me rastin e festave të fundvitit)? A ka pasur sponsorizim nga bizneset private në këtë shumë të investuar në	11.12.2023	Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion datë 04.12.2023, sipas të dhënave të marra nga Drejtoria e Përgjithshme e Financës, Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, ju bëjmë me dije se: 1. Sa para ka shpenzuar Bashkia për dekorimin e qytetit në dhjetorin e vitit 2023 (me rastin e festave të fundvitit)?	E plotë	S'ka tarifë

		kuadër të dekorimit të qytetit për fundvit? Nëse po, cilat biznese janë? Sa përqind e buxhetit të bashkisë është shpenzuar për dekorimin e qytetit?		- Dekori i qytetit për vitin 2023 është planifikuar në vlerën 15,100,000 lekë. 2. A ka pasur sponsorizim nga bizneset private në këtë shumë të investuar në kuadër të dekorimit të qytetit për fundvit? Nëse po, cilat biznese janë? - Jo, nuk ka pasur sponsorizime për dekor. 3. Sa përqind e buxhetit të bashkisë është shpenzuar për dekorimin e qytetit? - Planifikimi i shpenzimeve për dekor zë 0,65 % të buxhetit të Bashkisë.		
31.	14.12.2023	Kërkesë për t'u pajisur me informacion mbi numrin e fëmijëve Rom dhe Egjiptian që kanë përfituar mbështetje financiare bazuar tek VKM 666 datë 10.10.2019 në kategorinë "Familje në nevojë".	26.12.2023	Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion datë 12.12.2023, sipas të dhënave të marra nga Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes ju bëjmë me dije se: Numri i nxënësve rom dhe egjiptianë të cilët kanë përfituar bursë përgjatë vitit shkollor 2023-2024 sipas VKM nr. 666, datë 10.10.2019 është: - 243 nxënës të shkollave 9 vjeçare; - 9 nxënës të shkollave të mesme.	E plotë	S'ka tarifë

32.	11.12.2023	<p>Kërkesë për t'u pajisur me informacion: 1.A është konsultuar me publikun Buxheti Vjetor 2023 dhe 2024 i Bashkisë? Nëse po, më përcillni kopje të njoftimit/njoftimeve për zhvillimin e dëgjesave publike, kur dhe ku është publikuar njoftimi/njoftimet, kopje të procesverbaleve të mbajtura, kopje të rekomandimeve dhe dokumente të tjera që mbështesin realizimin e këtij procesi.</p> <p>2. A është konsultuar me publikun paketa e taksave dhe tarifave vendore për periudhën 2023-2024? Nëse po, më përcillni kopje të njoftimit/njoftimeve për zhvillimin e dëgjesave publike, kur dhe ku është publikuar njoftimi/njoftimet, kopje të procesverbaleve të mbajtura, kopje të</p>	26.12.2023	<p>Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion datë 11.12.2023, ju bëjmë me dije se:</p> <p>1-2. Bashkia Korçë ka zhvilluar konsultimet publike për "Buxhetimin me Pjesëmarrje" dhe "Paketën Fiskale", për vitet 2023 dhe 2024. Njoftimi për zhvillimin e dëgjesave publike është bërë në faqen zyrtare të web-it si edhe në faqen zyrtare në rrjetet sociale. Njoftimet për Buxhetin 2023:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Njësia Administrative Drenovë: <a href="https://bashkiakorces.gov.al/site/article.php?aid=4308&amp;t=Njoftim">https://bashkiakorces.gov.al/site/article.php?aid=4308&amp;t=Njoftim</a></li> <li>- Njësia Administrative Voskopojë dhe Lekas: <a href="https://bashkiakorces.gov.al/site/article.php?aid=4293&amp;t=Njoftim">https://bashkiakorces.gov.al/site/article.php?aid=4293&amp;t=Njoftim</a></li> <li>- Njësia Administrative Mollaj: <a href="https://bashkiakorces.gov.al/site/article.php?aid=4291&amp;t=Njoftim">https://bashkiakorces.gov.al/site/article.php?aid=4291&amp;t=Njoftim</a></li> <li>- Njësia Administrative Voskop: <a href="https://bashkiakorces.gov.al/site/article.php?aid=4290&amp;t=Njoftim">https://bashkiakorces.gov.al/site/article.php?aid=4290&amp;t=Njoftim</a></li> <li>- Njësia Administrative Vithkuq: <a href="https://bashkiakorces.gov.al/site/article.php?aid=4285&amp;t=Njoftim">https://bashkiakorces.gov.al/site/article.php?aid=4285&amp;t=Njoftim</a></li> <li>- Njësia Administrative Bulgarec: <a href="https://bashkiakorces.gov.al/site/article.php?aid=4284&amp;t=Njoftim">https://bashkiakorces.gov.al/site/article.php?aid=4284&amp;t=Njoftim</a></li> </ul> <p>Qyteti:</p>	E plotë	S'ka tarifë
-----	------------	---	------------	---	---------	-------------

		<p>rekomandimeve dhe dokumente të tjera që mbështesin realizimin e këtij procesi.</p> <p>3. A është konsultuar me publikun tjetërsimi i pronave të Bashkisë për periudhën Janar 2023-Dhjetor 2023? Nëse po, më përcillni kopje të njoftimit/njoftimeve për zhvillimin e dëgjësive publike, kur dhe ku është publikuar njoftimi/njoftimet, kopje të procesverbaleve të mbajtura, kopje të rekomandimeve dhe dokumente të tjera që mbështesin realizimin e këtij procesi.</p> <p>4. A janë njoftuar paraprakisht në faqen e internetit ose stendën e informimit data dhe ora e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak për periudhën Janar 2023-Dhjetor 2023? Nëse po, më përcillni kopje të njoftimit/njoftimeve për zhvillimin e këtyre</p>		<p><a href="https://bashkiakorces.gov.al/site/article.php?aid=4286&amp;t=Njoftim">https://bashkiakorces.gov.al/site/article.php?aid=4286&amp;t=Njoftim</a>  <a href="https://bashkiakorces.gov.al/site/article.php?aid=4292&amp;t=Njoftim">https://bashkiakorces.gov.al/site/article.php?aid=4292&amp;t=Njoftim</a></p> <p>Njoftimet për Buxhetin 2024:  -Njësia Administrative Vithkuq:  <a href="https://bashkiakorces.gov.al/site/article.php?aid=4790&amp;t=Njoftim">https://bashkiakorces.gov.al/site/article.php?aid=4790&amp;t=Njoftim</a>  - Njësia Administrative Mollaj:  <a href="https://bashkiakorces.gov.al/site/article.php?aid=4789&amp;t=Njoftim">https://bashkiakorces.gov.al/site/article.php?aid=4789&amp;t=Njoftim</a>  -Njësia Administrative Voskop:  <a href="https://bashkiakorces.gov.al/site/article.php?aid=4787&amp;t=Njoftim">https://bashkiakorces.gov.al/site/article.php?aid=4787&amp;t=Njoftim</a>  -Njësia Administrative Voskopoje dhe Lekas:  <a href="https://bashkiakorces.gov.al/site/article.php?aid=4788&amp;t=Njoftim">https://bashkiakorces.gov.al/site/article.php?aid=4788&amp;t=Njoftim</a>  -Njësia Administrative Drenovë:  <a href="https://bashkiakorces.gov.al/site/article.php?aid=4795&amp;t=Njoftim">https://bashkiakorces.gov.al/site/article.php?aid=4795&amp;t=Njoftim</a>  Njësia Administrative Bulgarec:  <a href="https://bashkiakorces.gov.al/site/article.php?aid=4794&amp;t=Njoftim">https://bashkiakorces.gov.al/site/article.php?aid=4794&amp;t=Njoftim</a>  Qytet:  <a href="https://bashkiakorces.gov.al/site/article.php?aid=4791&amp;t=Njoftim">https://bashkiakorces.gov.al/site/article.php?aid=4791&amp;t=Njoftim</a></p> <p>Procesverbalet e mbajtura i gjeni të publikuara në Programin e Transparencës, link-u bashkangjitur:</p>		
--	--	--	--	--	--	--

		<p>mbledhjeve, kur dhe ku është publikuar njoftimi/njoftimet, kopje të procesverbaleve të mbajtura dhe dokumente të tjera që mbështesin realizimin e këtij procesi.</p> <p>5. A janë njoftuar paraprakisht në faqen e internetit ose stendën e informimit data dhe ora e mbledhjeve të Komisioneve të Këshillit Bashkiak për periudhën Janar 2023-Dhjetor 2023? Nëse po, më përcillni kopje të njoftimit/njoftimeve për zhvillimin e këtyre mbledhjeve, kur dhe ku është publikuar njoftimi/njoftimet, kopje të procesverbaleve të mbajtura dhe dokumente të tjera që mbështesin realizimin e këtij procesi.</p> <p>6. A shfaqen në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike,</p>		<p><a href="https://sites.google.com/view/bashkiakor/home/pjes%C3%ABmarrja-qytetare-n%C3%AB-vendimmarrje/procedura-e-marrjes-dhe-shqyrtimit-t%C3%AB-komenteve-dhe-rekomandimeve">https://sites.google.com/view/bashkiakor/home/pjes%C3%ABmarrja-qytetare-n%C3%AB-vendimmarrje/procedura-e-marrjes-dhe-shqyrtimit-t%C3%AB-komenteve-dhe-rekomandimeve</a></p> <p>3. Ligji Nr. 146/2014 « Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik » rregullon procesin e njoftimit dhe të konsultimit publik të projektligjeve, projektdokumenteve strategjike kombëtare dhe vendore, si dhe politikave me interes të lartë publik.</p> <p>Referuar Nenit 2 “Përkufizime” te këtij ligji.</p> <p>1. “Akt administrativ individual” është çdo vullnet i shprehur nga organi publik, në ushtrim të funksionit të tij publik, ndaj një ose disa subjekteve individualisht të përcaktuara të së drejtës, që krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete.</p> <p>Referuar Nenit 4 “Kufizime”</p> <p>Dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen gjatë procesit të vendimmarrjes që lidhet me:</p> <p>.....</p> <p>.....</p> <p>c) aktet administrative individuale dhe aktet administrative me karakter normativ, përveçse kur me</p>		
--	--	--	--	--	--	--

		<p>njoftime për organizimin e Dëgjesave Publike nga Këshilli Bashkiak për periudhën Janar 2023-Dhjetor 2023? Nëse po, më përcillni kopje të njoftimit/njoftimeve për zhvillimin e këtyre dëgjesave, kur dhe ku është publikuar njoftimi/njoftimet, kopje të procesverbaleve të mbajtura dhe dokumente të tjera që mbështesin realizimin e këtij procesi.</p> <p>7. A ka qenë Bashkia juaj ndonjëherë përfituese e Fondit Social që nga krijimi i tij dhe nëse po, sa ka qenë periudha për të cilën është ofruar mbështetje dhe në çfarë vlere monetare?</p>		<p>ligj të veçantë parashikohet ndryshe;</p> <p>Me ligj të vecantë, konkretisht me ligjin 139/2015 « Për vetëqeverisjen vendore » parashikohet : “Neni 18” Seancat e këshillimeve me bashkësinë : Këshilli bashkiak ose këshilli i qarkut, përpara shqyrtimit dhe miratimit të akteve, zhvillon seanca këshillimi me bashkësinë, të cilat janë të detyrueshme për rastet e parashikuara në nenet 54, shkronjat “a”, “dh”, “e”, “f” dhe “k”, dhe 77, shkronjat “a”, “dh”, “e”, “f” dhe “k”, të këtij ligji.</p> <p>Shkronja e) e nenit 54 të ligjit për vetëqeverisjen vendore citon : Këshilli bashkiak ka këto detyra dhe kompetenca:</p> <p>.....</p> <p>.....</p> <p>e) miraton tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve;</p> <p>Në referim të dispozitave të sipërcituara, rezulton se aktet e kalimit të pronësisë të miratuara nga Këshilli Bashkiak janë akte administrative individuale, për të cilat detyrimi për konsultim publik i takon Këshillit Bashkiak. Por, duke qenë se këto akte kanë efekt</p>		
--	--	---	--	---	--	--

			<p>vetëm mbi një individ të caktuar, pra nuk kanë efekt normativ, pasi janë vendime marrë në bazë të VKM-së 329/2019, vendim i cili ka për qëllim të kalojë trojet e ngelura në pronësi shtetërore në favor të pronarëve të ndërtesave. Pra, qëllimi i këtyre vendimeve është plotësimi i dokumentacionit të kalimit të pronësisë i cili është miratuar me Vendime të mëparshme të organeve kolegjiale vendore. Konsultimi publik mbi një akt tjetërsimi pasurie i cili kryhet vetëm për efekt regjistrimi në zyrën e regjistrimit nuk është në interes të një procedure administrative eficiente.</p> <p>4. Njoftimet për mbledhjet e Këshillit Bashkiak për periudhën Janar-Dhjetor 2023, janë bërë në faqen zyrtare të webit në kategorinë "Këshilli Bashkiak". Bashkangjitur po ju vendosim në dispozicion link-un:</p> <p><a href="https://bashkiakorce.gov.al/site/articles.php?cid=388&amp;t=Njoftimet&amp;page=1">https://bashkiakorce.gov.al/site/articles.php?cid=388&amp;t=Njoftimet&amp;page=1</a></p> <p>Procesverbalet e mbledhjeve i gjeni të publikuara në link-un bashkangjitur:</p> <p><a href="https://bashkiakorce.gov.al/site/articles.php?cid=420&amp;t=Proces-">https://bashkiakorce.gov.al/site/articles.php?cid=420&amp;t=Proces-</a></p>	
--	--	--	--	--

			<p>verbale-te-mbledhjev-te-Keshillit-Bashkiak.</p> <p>Gjithashtu, njoftimi për mbledhjet e Këshillit bëhet edhe në faqen zyrtare të Këshillit në facebook.</p> <p>Mbledhjet e këshillit bashkiak mund të ndiqen live në faqen zyrtare të këshillit në facebook: <a href="https://www.facebook.com/KeshilliBashkiakKorce/">https://www.facebook.com/KeshilliBashkiakKorce/</a>.</p> <p>5. Në njoftimin që bëhet për mbledhjet e Këshillit Bashkiak është edhe njoftimi për mbledhjet e Komisioneve.</p> <p>6. Bashkangjitur do të gjeni link-un ku është i publikuar Regjistri i Projekt Akteve për konsultim publik i Këshillit Bashkiak:</p> <p><a href="https://docs.google.com/spreadsheets/d/1UYq08gHYMKzLUkFPmSmrxxgp-eEa5kX1rWOO3cgW5c/edit#gid=0">https://docs.google.com/spreadsheets/d/1UYq08gHYMKzLUkFPmSmrxxgp-eEa5kX1rWOO3cgW5c/edit#gid=0</a>.</p> <p>Edhe në kategorinë Njoftime/Këshilli Bashkiak bëhen publike njoftimet për konsultimet publike: <a href="https://bashkiakorce.gov.al/site/articles.php?cid=388&amp;t=Njoftimet">https://bashkiakorce.gov.al/site/articles.php?cid=388&amp;t=Njoftimet</a>.</p> <p>7. Bashkia Korçë është përfutuese e Fondit Social për një periudhë 3</p>	
--	--	--	--	--

				vjeçare (2020-2023). Vlera monetare është 13,117,740 lekë.		
33.	17.12.2023	Kërkesë për t'u pajisur me informacion mbi numrin e bizneseve të hapura në vitin 2022 dhe 2023 si dhe numri i bizneseve të mbyllura në vitin 2022 dhe 2023.	26.12.2023	Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion datë 17.12.2023, po ju vendosim në dispozicion të dhënat e marra nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Korçë. 1. Subjekte të regjistruara për vitin 2022 janë 417, ndërsa për vitin 2023 janë 333. 2. Subjekte që kanë aplikuar për çregjistrim për vitin 2022 janë 256, ndërsa për vitin 2023 janë 205.	E plotë	S'ka tarifë
34.	27.12.2023	Kërkesë për t'u pajisur me informacion mbi : 1.Sa punonjës janë në pozicionin e koordinatorit vendor, për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare në juridiksionin e bashkisë tuaj? 2.Në sa raste (përgjatë viteve 2018, 2019, 2020 , 2021, 2022, 2023) koordinatori ka	28.12.2023	Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion datë 27.12.2023, sipas të dhënave të marra nga Drejtoria e Kujdesit Social pranë Bashkisë Korçë, më poshtë gjeni përgjigjet për pyetjet tuaja. 1. Sa punonjës janë në pozicionin e koordinatorit vendor, për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare në juridiksionin e bashkisë tuaj? Bashkia Korçë ka të emëruar 1(një) punonjës në pozicionin e Koordinatorit Vendor për Dhunën në Familje që merret me trajtimin e	E plotë	S'ka tarifë

		<p>bashkëpunuar me policinë e shtetit (në sa raste titullari i policisë së shtetit ka njoftuar menjëherë koordinatorin për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare)?</p> <p>3. Sa qendra sociale të rehabilitimit janë ngritur pranë juridiksionit të bashkisë tuaj, për viktimat e dhunes në familje?</p> <p>4. Sa struktura të qendrave publike janë për trajtimin, trajnimin dhe rehabilitimin e dhunuesve pranë juridiksionit të bashkisë tuaj?</p> <p>5. A keni bashkëpunuar me shërbimin e provës, për monitorimin e ekzekutimit të urdhrave të mbrojtjes?</p>	<p>rasteve të dhunës dhe 1 (një) Specialiste për Barazinë Gjinore.</p> <p>2. Në sa raste (përgjatë viteve 2018, 2019, 2020 , 2021, 2022, 2023) koordinatori ka bashkëpunuar me policinë e shtetit (në sa raste titullari i policisë së shtetit ka njoftuar menjëherë koordinatorin për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare)?</p> <p>Bashkëpunimi ndërmjet Koordinatorit Vendor dhe Policisë së Shtetit realizohet në çdo rast të dhunës në marrëdhëniet familjare. Ky bashkëpunim ndërmjet të dyja institucioneve ka qenë për të gjitha vitet e sipërpërmendura. Gjithashtu për të gjitha rastet e dhunës të denoncuar në polici kjo strukturë njofton menjëherë Koordinatorin Vendor të Bashkisë Korçë, i cili në çdo rast dhe në çdo kohë (24/7), paraqitet pranë komisariatit ku së bashku me policinë asistojnë dhe bëjnë vlerësimin e riskut.</p> <p>3. Sa qendra sociale të rehabilitimit janë ngritur pranë juridiksionit të bashkisë tuaj, për viktimat e dhunes në familje?</p> <p>Në Bashkinë Korçë prej 9 vitesh është e ngritur një Qendër Emergjence për strehimin</p>		
--	--	--	---	--	--

				<p>emergjent të viktimave të dhunës në familje. Kjo qendër menaxhohet në bashkëpunim me fondacionin “Mëshirë Pa Kufi Për Shqipërinë” në të cilën vikitmat e dhunës në familje marrin shërbimet si: strehim të sigurt, ushqim, veshje, shërbim psikologjik etj.</p> <p>4. Sa struktura të qendrave publike janë për trajtimin, trajnimin dhe rehabilitimin e dhunuesve pranë juridiksionit të bashkisë tuaj? Për trajtimin, trajnimin dhe rehabilitimin e dhunuesve pranë juridiksionit të Bashkisë Korçë akoma nuk është ngritur një qendër e posaçme për të trajtuar dhunuesit.</p> <p>5. A keni bashkëpunuar me shërbimin e provës, për monitorimin e ekzekutimit të urdhrave të mbrojtjes? Bashkia Korçë për trajtimin e rasteve të dhunës bashkëpunon me të gjithë institucionet dhe sipas natyrës së rastit edhe me Shërbimin e Provës.</p>		
35.	28.12.2023	Kërkesë për t’u pajisur me informacion për shumën e paguar për konsumin e energjisë elektrike për institucionin e Bashkisë	10.01.2024	Kërkuesit i është vendosur në dispozicion tabela (në Excel) me të dhënat e kërkuara.	E plotë	S’ka tarifë

		Korçë për periudhën 01.10.2021-20.10.2023.				
--	--	---	--	--	--	--